

**STATUTI I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“DV8” SH.P.K.**

**I. THEMELIMI**

**Neni 1**  
**Preamble**

Shoqëria “DV8” SH.P.K. (referuar përgjatë dokumentit si “*Shoqëria*”), themelohet nga ortakët themelues:

- **Z. Albert Leka**, shtetas shqiptar, lindur në Dritaj më datë 13-09-1980 identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 033169349 dhe me nr. personal I00913084E
- **Z. Rezart Joanidhi**, shtetas shqiptar, lindur në Kucove më datë 19-03-1987 identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. BC5860277 dhe me nr. personal I70319059T

Si një person juridik shqiptar i cili funksionon në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

*ATËHERË*, themeluesit e Shoqërisë, Z. Albert Leka dhe Z. Rezart Joanidhi ,kanë hartuar dhe miratuar këtë Statut në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në veçanti me dispozitat e Nenit 68 e në vazhdim të këtij Ligji, ku rregullohen hollësishët çështjet e organizimit, të funksionimit dhe të veprimitarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, kjo në përputhje me ligjin shqiptar dhe çdo legjislacion të mëvonshëm të zbatueshëm.

**Neni 2**  
**Ortakët**

Ortakët e Shoqërisë janë Z. Albert Leka, shtetas shqiptar, lindur në Dritaj ,më datë 13-09-1980, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 033169349 dhe me nr. personal I00913084E dhe Z. **Rezart Joanidhi** shtetas shqiptar, lindur në Kucove ,më datë 19-03-1987 ,identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr.BC5860277 dhe me nr. personal I70319059T (në vijim referuar si “*Ortakët*”).

Kontributet e Ortakëve në kapitalin e shoqërisë janë në para. Kontributet e Ortakëve në para nuk do të janë më pak se 50,000 Eur Kundervlepta ne Lek 5,381,500 (duke ju referuar kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise ne Daten 23.08.2023 i cili eshte 107.63).

Duke u nisur nga kontributet në para të dhëna në kapital nga Ortakët, Z. Albert Leka zotëron një kuotë që përfaqëson 34% (tridhjetë e katër përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë dhe Z. Rezart Joanidhi zotëron një kuotë që përfaqëson 66% (gjashtëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Ortakët do te derdhin kontributin e tyre në kapitalin e Shoqërisë, me qëllim që të përfitojnë të

ardhura që burojnë nga veprimtaria e Shoqërisë, duke mos u përgjigjur për detyrimet e Shoqërisë, por duke mbuluar personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Për mënjanimin e çdo dyshimi, Ortakët gjëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributeve përkatëse të tyre në kapitalin e përfaqësuar në pjesë kapitali.

## **II. EMËRTIMI- SELIA-FORMA LIGJORE-OBJEKTI**

### **Neni 3** **Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është shoqëria tregtare “DV8” SH.P.K.  
Emri tregtar i shoqërisë është “DV8” SH.P.K.

### **Neni 4** **Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga Rr. Janos Hunyadi, Pallati “Domus”  
Kati 6, Ap. 19, 1001, Tiranë, Albania Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të zhvendosë selinë e saj ose të krijojë një seli operative në një vendndodhje tjeter në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi kudo brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, me miratim paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

### **Neni 5** **Forma Ligjore**

Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.), në përputhje me dispozitat e Nenit 68 e në vazhdim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

### **Neni 6** **Baza Ligjore**

Shoqëria “DV8” SH.P.K, do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe të gjitha dispozitat e tjera të detyrueshme në bazë të legjislacionit shqiptar.

### **Neni 7** **Emblema dhe Vula**

Shoqëria do të ketë emblemët dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Administratori. Forma e vulës dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

### Neni 8 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë vijon:

1. Veprimtari tregtare bar-kafe-bufe, në formë autonome ose franchising;
2. Tregtim i të gjithë produkteve të bar-kafe-bufesë, në formë autonome ose franchising;
3. Veprimtari ekonomike për shërbime bar, kafe, ushqim;
4. Veprimtari ekonomike për shërbime video, shërbime design, dizajnim dhe koordinimin (implementim/zbatim) aktivitetesh, si dhe konsulenca;
5. Veprimtari ekonomike për menaxhim, shërbime facilitare për bizneset, import-eksport, tregtim me shumicë i artikujve të ndryshëm industrialë, ushqimorë, workshop, etj.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka të bëjë me objektivat e renditura sa më lart. Për të arritur qëllimet e mësipërme, Shoqëria mund të ndërmarrë aktivitet tregtar, financiar, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në menyrë që të arrihet dhe përmbushet objekti i Shoqërisë.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të ngushtohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### III. KOHËZGJATJA

### Neni 9 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pakufizuar. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë kufizim kohor në jetëgjatësinë e Shoqërisë.

### IV. KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 10 Kapitali

Kapitali fillestari i Shoqërisë do te jete ne Vleren 50,000 Euro i konvertuar ne monedhen shqiptare sipas kursit zyrtar te kembimit te publikuar nga Banka e Shqiperise ne daten e Krijimit te ketij Statuti.

Kapitali i Shoqërisë eshte i ndarë në 2 (dy) kuota si ne vijim:

Ortaket	Kuota ne %	Vlera e Kapitalit ne Eur	Kursi I Kembimit Zyrtar 23.08.2023	Vlera Kapitalit ne All
Albert Leka	34%	€ 17,000	107.63	1,829,710
Rezart Joanidhi	66%	€ 33,000	107.63	3,551,790
<b>Total</b>	<b>100%</b>	<b>€ 50,000</b>		<b>5,381,500</b>

Z. Albert Leka zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 34 (tridhjetë e katër) Lekë, që përfaqëson 1 (një) pjesë dhe me pjesëmarrje në përqindje 34% (tridhjetë e katër) përqind të kapitalit themeltar të Shoqërisë ne vleren Eur 17,000 kundervlefta ne Lek sipas kursit zyrtar te kembimit te dates 23.08.2023 sipas Bankes se Shqiperise 1,829,710 Leke.

Z. Rezart Joanidhi zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, që përfaqëson 1 (një) pjesë dhe me pjesëmarrje në përqindje 66% (gjashtëdhjetë e gjashtë) përqind të kapitalit themeltar të Shoqërisë ne vleren Eur 33,000 kundervlefta ne Lek sipas kursit zyrtar te kembimit te dates 23.08.2023 sipas Bankes se Shqiperise 3,551,790 Leke.

Secili prej Ortakeve do te kryeje Pagesen Respektive te pjeses se tij takuese te kontributit ne para per kapitalin e Shoqerise ne llogarite bankare te Shoqerise te Celur prane cdo banke ne Shqiperi brenda 60 diteve nga regjistrimi i Shoqerise.


Nënshkrimi dhe shlyerja e pjesëve të mëtejshme të kapitalit mund të bëhet me para ose me kontribute në natyrë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### Neni 10/1 Marrëdhëniet ndërmjet Ortakëve dhe e Drejta e Votës në Shoqëri

Në përputhje me nenin 68, pika 4, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", marrëdhëniet ndërmjet Ortakëve do të përcaktohen sipas këtij Statuti, në bazë të të cilët do të lidhet edhe një Marrëveshje Ortakësh. Në këtë Marrëveshje, në përputhje me nenin 88, pika 5, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ortakët do të përcaktojnë detyrimin për të marrë unanimisht çdo vendim sipas këtij Statuti, si dhe vendime të natyrës tregtare, menaxheriale dhe teknike (të dijes së veprimtarisë tregtare) që duhet të merren me unanimitet nga Ortakët.

Në përputhje me nenin 88, pika 1, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ortakët bien dakort se pesha e votës (e drejta e votës) së secilit prej tyre në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë nuk do të jetë e barabartë (në përpjestim) me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë apo me vlerën nominale të kuotës.

Ortaku Z. Albert Leka që zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 34 (tridhjetë e katër) Lekë, që përfaqëson 1 (një) pjesë dhe me pjesëmarrje në përqindje 34% (tridhjetë e katër) përqind të kapitalit themeltar të Shoqërisë, do të zoterojë një votë në Asamblenë e Përgjithshme të



Shoqërisë që do të ketë peshë në vendimmarje të Asamblesë (të drejtë vote) të barabartë (në përpjestim) me 50% (pesëdhjetë) përqind të vendimmarjes.

Ortaku Z. Rezart Joanidhi që zoteron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, që përfaqëson 1 (një) pjesë dhe me pjesëmarrje në përqindje 66% (gjashtëdhjetë e gjashtë) përqind të kapitalit themeltar të Shoqërisë, do të zoterojë një votë në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë që do të ketë peshë në vendimmarje të Asamblesë (të drejtë vote) të barabartë (në përpjestim) me 50% (pesëdhjetë) përqind të vendimmarjes.

Të gjithë raportet dhe marrëdhëniet e tjera ndërmjet Ortakëve, që nuk janë përcaktuar në këtë Statut, të drejtat dhe detyrimet e tyre në raport me Shoqërinë dhe me njëri-tjetrin, që nuk janë përcaktuar në këtë Statut, do të përcaktohen në Marrëveshjen e Ortakëve, duke respektuar dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë Statut dhe veçanërisht në këtë dispozitë të Statutit dhe në nenin 15 të tij. Palët bien dakort se në rast mospërputhje të parashikimeve të këtij Statuti me parashikimet e Marrëveshjes së Ortakëve, janë parashikimet e këtij Statuti që do të kenë epërsi dhe do të prevalojnë.

### Neni 11 Transferimi i kuotave/pjesëve të kapitalit themeltar

Kuotat/Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen/tjetërsohen me akt notarial ose me kontratë jo notoriale.

Pjesët e kapitalit transferohen automatikisht në rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakëve të Shoqërisë, si dhe shoqërise të kontrolluara prej tyre në rast se ka të tilla.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'i transferohen/tjetërsohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, kjo pa miratimin e ortakëve të tjerë, nëse është respektuar e drejta e parablerjes së ortakëve të tjerë sipas parashikimeve të këtij Statuti në nenin 12 të tij.

E drejta për të tjetërsuar kuotën i përket vetëm Ortakut që zoteron kuotën dhe nuk ka nevojë për miratim/autorizim nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë apo nga Ortakët e tjerë.

Çdo transferimi/tjetërsim i kapitalit themeltar bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### Neni 12 E drejta e parablerjes

Transferimi për çfarëdo arsy, tërësisht ose pjesërisht i kuotave/pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër, i cili mund të ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njofimit të dërguar me postë (postë fizike ose e-mail), i cili përmban një ofertë për kuotën që shitet, çmimin dhe mënyrën e pagesës.

Në rast se ortaku i cili mban të drejtën e parablerjes nuk përgjigjet brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor të lartpërmendur, ose e refuzon shprehimisht ofertën e ortakut shitës, atëherë konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e parablerjes së pjesave të kapitalit që do të tjetërsohen. Në këtë rast, ortaku shitës ka të drejtë të tjetërsojë/shesë kuotën e tij tek çdo palë e tretë që nuk bën pjesë në Shoqëri, pa pasur nevojë për asnjë lloj miratimi nga ortakët e tjerë.

**Neni 13**  
**Zmadhimi i kapitalit themeltar**

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën ekskluzive për të marrë vendimin për zmadhimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kapitali themeltar i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në para apo në natyrë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Ortakët mund të rrisin pjesën e tyre në kontributin e kapitalit themeltar vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me pjesëmarrjen e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e kapitalit të Shoqërisë.

Zmadhimi i kapitalit i realizuar nga njëri prej ortakëve nuk i detyron ortakët e tjera të rrisin edhe ata pjesën e tyre.

Vendimi i zmadhimit të kapitalit themeltar mund të sjellë edhe riorganizimin e numrit dhe vlerës së secilës pjesë të tij dhe zotërimin e tyre nga ortakët.

Rritja e kapitalit themeltar mund të realizohet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të reja të kapitalit nga ortakë të rindërtuar. Ortakët e rindërtuar do të pranohen si të tillë me vendim unanim të ortakëve në të njëjtën mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme që miraton zmadhimin e kapitalit themeltar.

**Neni 14**  
**Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

Zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet ekskluzivisht me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Kapitali themeltar nuk mund të jetë më i vogël sesa minimumi i përcaktuar me ligj (100 Lekë), përndryshe Shoqëria eshtë e detyruar që të ndryshojë formën e saj juridike apo të shpërbëhet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Zvogëlimi i kapitalit miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me pjesëmarrje të ortakëve që përfaqësojnë  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e kapitalit themeltar të Shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**V. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- dhe
- Administratori

**Neni 15**



6

## Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortakët e Shoqërisë.

Në përputhje me nenin 88, pika 1, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në përputhje me nenin 10/1 të këtij Statuti, Ortakët bien dakort se pesha e votës (e drejta e votës) së secilit prej tyre në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë nuk do të jetë e barabartë (në përpjestim) me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë apo me vlerën nominale të kuotës.

Përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ky Statut, Asambleja e Përgjithshme i merr vendimet gjithmonë sipas ndarjes së peshës së votës (të drejtës së votës) në Asamble, siç është përcaktuar në nenin 10/1 të këtij Statuti dhe në këtë dispozitë më poshtë.

Ortaku Z. Albert Leka që zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 34 (tridhjetë e katër) Lekë, që përfaqëson 1 (një) pjesë dhe me pjesëmarrje në përqindje 34% (tridhjetë e katër) përqind të kapitalit themeltar të Shoqërisë, do të zotërojë një votë në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë që do të ketë peshë në vendimmarrje të Asamblesë (të drejtë vote) të barabartë (në përpjestim) me 50% (pesëdhjetë) përqind të vendimmarrjes.

Ortaku Z. Rezart Joanidhi që zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, që përfaqëson 1 (një) pjesë dhe me pjesëmarrje në përqindje 66% (gjashtëdhjetë e gjashtë) përqind të kapitalit themeltar të Shoqërisë, do të zotërojë një votë në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë që do të ketë peshë në vendimmarrje të Asamblesë (të drejtë vote) të barabartë (në përpjestim) me 50% (pesëdhjetë) përqind të vendimmarrjes.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:

- ndryshimin e Statutit;
- përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- likuidimin e Shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e administratorit të Shoqërisë, likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- vendos për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;

7

- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë ;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë për ushtrimin e të gjitha tagrave të dhëna nga dispozitat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në veçanti për mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

Në përputhje me nenin 87, pika 1, dhe me nenin 88, pika 5, të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështjet sipas nenit 87, pika 1, të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, siç janë ndryshimi i Statutit, zvogëlimi ose zmadhimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve/dividendit, riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë, si dhe hapja e brancheve/lokaleve të reja, apo hyrja në një marrëdhënie kontraktore franchise, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren në mënyrë të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë numrin total të votave të Shoqërisë janë të pranishëm dhe votojnë me unanimitet (me numrin total të votave) të ortakëve të Shoqërisë.

Në përputhje me nenin 87, pika 2, dhe me nenin 88, pika 5, të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështjet e renditura në Nenin 81 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren në mënyrë të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë numrin total të votave të Shoqërisë janë të pranishëm dhe votojnë me unanimitet (me numrin total të votave) të ortakëve të Shoqërisë.

Në përputhje me nenin 88, pika 5, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ortakët do të përcaktojnë detyrimin për të marrë unanimisht çdo vendim sipas këtij Statuti, si dhe vendime të natyrës tregtare, menaxheriale dhe teknike (të dijes së veprimtarisë tregtare) që duhet të merren me unanimitet nga Ortakët.

Në rast se Shoqëria shndërrohet në një shoqëri me ortak të vetëm, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme me ortak të vetëm, për çështjet që parashikon neni 87, pika 1, i Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” do të njësohen me  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e votave të një Asambleje të Përgjithshme me dy ose më shumë ortakë dhe për çështjet që parashikon neni 81 i Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” do të njësohen me shumicën e votave të një Asambleje të Përgjithshme me dy ose më shumë ortakë.

Në rast se Shoqëria shndërrohet në një shoqëri me ortak të vetëm, të gjithë vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme me Ortak të Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: (i) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; (ii) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; (iii) investime; (iv) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Kjo pavlefshmëri nuk mund t'i kundrejtohet të tretëve që kanë fituar të drejta në mirëbesim nga Shoqëria, përvèç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, ose kur provon se, duke u bazuar në rr Ethanat e veçanta, i treti nuk mund të mos kish patur dijeni për pavlefshmërinë.

Neni 16  
Thirrja dhe Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Mënyra e thirrjes, mbledhja dhe regjistrimi i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhen në përputhje me dispozitat e neneve 81, 82 dhe 83 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përbajë orën, datën, vandin e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Lajmërimi bëhet nga Administratori i Shoqërisë. Njoftimi do të dërgohet në adresën që rezulton në Librin e Shoqërisë ose sipas adresës së regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas specifikimeve të mësipërme, atëherë Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët bien dakort për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Mbledhja e Asamblesë mund të bëhet edhe sipas irregullave procedurale të mbledhjes të miratuara nga vetë Asambleja e Përgjithshme.

Neni 17  
Administratori

Shoqëria administrohet nga 1 (një) ose më tepër se 1 (një) Administrator (në rast të shtimit në të ardhmen të numrit të administratorëve), i emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Numri i administratorëve mund të ndryshohet sa herë që Asambleja e Përgjithshme e gjykon të arsyeshme. Administratori mund të jetë i çdo kombësie dhe emërohet për një periudhë jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet, me të drejtë riemërimi.


Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Albert Leka, shtetas shqiptar, lindur në Dritaj më datë 13-09-1980, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 033169349 dhe me nr. personal I00913084E me afat mandati 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. **Albert Leka** shtetas shqiptar, lindur në Dritaj më datë 13-09-1980, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. I00913084E dhe me nr. personal BG3818830 me afat mandati 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

Në rast dorëheqjeje, pushimi nga puna apo skualifikimi të ndonjë Administratori, pasardhësi që do të zërë vendin e Administratorit do të zgjidhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, menjëherë pas kësaj ngjarjeje, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë që nëpërmjet një vendimi të marrë me shkrim, të përfundojë para afatit mandatin e njërit ose të gjithë Administratorëve, pa pasur nevojën dhe detyrimin të shtrojë arsyet e motivuar për këtë shkarkim.

Pas pranimit të emërit, Administratorët do të deklarojnë me shkrim që marrëdhënia e tyre



me Shoqerinë është ngritur mbi baza besimi. Në këtë kontekst, vendimi për t'i shkarkuar Administratorët me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të pamotivuar, gjykohet si një arsy legitime për heqjen e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.


Shoqëria mund të përfaqësohet nga 1 (një) Administrator edhe në qoftë se do të emërohen më shumë se 1 (një) Administratorë, ose nga të gjithë Administratorët e emëruar. Nëse do të emërohen më shumë se 1 (një) Administratorë, secili nga Administratorët ka të drejtë të ushtrojë të gjithë tagrat e përcaktuara nga ligji dhe nga ky Statut.

Administratorit i janë dhënë të gjitha tagrat për të vepruar, me qëllim për të krijuar marrëdhënie me palët e treta për interes të Shoqërisë, në të gjitha rrëthanat, përveç kur këto tagra kufizohen në përgjithësi nga ligji dhe përveç atyre të cilat në menyrë të shprehur u përkasin Asamblesë së Përgjithshme me ligj, akte të Shoqërisë, ose kanë një rëndësi të tillë për të cilat miratimi i Asamblesë së Përgjithshme është i domosdoshëm. Këto kufizime tagash të Administratorit (ëve) i kundrejtohen palëve të treta.

Aktiviteti i përditshëm i Shoqërisë kryhet nga Administratori (Administratorët) duke përfaqësuar apo vepruar në emër të Shoqërisë me palët e treta, institucionet publike apo private, duke hyrë në marrëveshje si dhe duke përfaqësuar Shoqerinë përballë gjykatave të shkallëve të ndryshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Kompetencat e Administratorit (Administratorëve) që përfaqëson/përfaqësojnë Shoqerinë për këtë qëllim përfshijnë:

- Të veprojë dhe nënshkruajë në emër të Shoqërisë; të punësojë apo të shkarkojë punonjësit e Shoqërisë;
- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- Të përfaqësojë Shoqerinë, sipas marrë veshjeve të ortakëve dhe vendimeve të Asamblesë;
- Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, eventualisht bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qëndrën Kombëtare të Biznesit;
- Të mbajë një regjistër ku të regjistrohen emri i plotë i ortakëve, emri i Shoqërisë, vendbanimi apo selia e ortakëve, përqindja përkatëse e interesit në kapitalin themeltar të Shoqërisë, transferimi i kuotave apo çdo ndryshim i të dhënave të mësipërme;
- Të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin



10

- e politikave tregtare dhe në lidhje me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi thelbësore për veprimtarinë e Shoqërisë;
- Të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme sa herë që e detyron ligji si dhe për marrjen e vendimeve që duhet miratimi i saj;
  - Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut, pa ndërhyrë kurrësesi në kompetencat që me ligj apo Statut i janë dhënë Asamblesë së Përgjithshme;
  - Të respektojë të gjithë marrë veshjet e ortakë ve dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme, në rast të shtimit të numrit të Administratorëve, mund të miratojë një vendim për t'u dhënë të gjithë Administratorëve kompetencë të përbashkët përfaqësimi.

Çdo Administrator, në kryerjen e aktiviteteve të tij përkatëse, duhet të jetë në konformitet me ligjin, rregullat e drejtimit që rregullojnë ndarjen e aktivitetit dhe procedurave për vendimet e drejtimit, të miratuara me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Çdo Administrator do të drejtojë aktivitetin e Shoqërisë dhe do të sigurojë zbatimin e të gjithë urdhërave dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Çdo Administrator do të kryejë edhe detyra të tjera siç mund të parashtronen nga Asambleja e Përgjithshme, dhe gjatë drejtimit normal të aktivitetit, mund të delegojë një pjesë të kompetencave dhe të tij përkatëse tek një ose disa zyrtarë të Shoqërisë, në përputhje me rregullat e procedurës së drejtimit që rregullojnë ndarjen e aktivitetit dhe me procedurën për vendimet e drejtimit, të miratuara me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Aktet dhe masat që tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të aktivitetit të Shoqërisë janë objekt i miratimit paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori (Administratorët) është/janë përgjegjës përkundrejt Shoqërisë dhe çdo personi të tretë për çdo shkelje të ligjit apo akteve të Shoqërisë, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Shoqëri, siç parashikohet në dispozitat e Nenit 98 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Administratori mban individualisht përgjegjësi përballë Shoqërisë ose të tretëve për shkeljet e mundshme të ligjit dhe/ose të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Administratori mund të zëvendësohet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, votë e marrë kjo me shumicë të zakonshme. Administratori mund të zëvendësohet në çdo moment me vendim të autoriteteve gjyqësore shqiptare për shkelje të ligjit.

Paga e Administratorit si dhe shpërblime të tjera përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme.

## VI. VITI FINANCIAR-LIKUIDIMI

Neni 18



II

## Viti finansiar

Viti finansiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më datë 1 Janar dhe duke mbaruar më datë 31 Dhjetor.

Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë së Shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të Shoqërisë pranë organeve tatumore dhe përfundon më datë 31 Dhjetor.

### Neni 19 Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

Administratori do të mbajë llogari financiare të përshtatshme dhe do të përgatisë raporte financiare për të pasqyruar me saktësi gjendjen financiare të Shoqërisë, në përputhje me parimet e kontabilitetit. Llogaritë dhe raportet financiare do të janë në formë dhe përbajtje në përputhje me standartet e kontabilitetit, sipas parashikimeve ligjore.

Kontabiliteti mbahet në gjuhën Shqipe dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë.



Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe duhet të hartohej për t'iu paraqitur organeve tatumore.

Shoqëria mund të marrë financime nga Ortakët ose nga ortaku i vetëm (në rast të shndërrimit me një ortak), nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim Shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Përgjithshme.

### Neni 20 Ekspertët kontabël të autorizuar

Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë të paktën një ekspert kontabël të jashtëm të pavarur, i cili do të jetë një ekspert kontabël i autorizuar (në vijim referuar si “**Eksperti Kontabël i Autorizuar**”). Eksperti Kontabël i Autorizuar do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të kontrollojë llogaritë e Shoqërisë, regjistrimet e veprimeve dhe transaksioneve të saj;
- Të vërtetojë, në përputhje me rregulloret përkatëse, raportin vjetor mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë (bilancin, pasqyrat financiare të humbjeve dhe fitimeve dhe raporte të tjera që lidhen me to) dhe të japë mendimin e tij nëse pasqyrat financiare pasqyrojnë me saktësi gjendjen financiare të Shoqërisë;
- Të informojë Administratorin(ët) dhe Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë për çdo parregullsi apo mangësi të vërejtur gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve apo llogarive të Shoqërisë të cilat mund të rezultojnë në humbje të konsiderueshme për Shoqërinë;
- Të rishikojë përshtatshmërinë e praktikave dhe procedurave të auditimeve dhe kontolleve të brendshme dhe, nëse është me vend, të



- japë rekomandime për përmirësimin e tyre;
- Të kryejë të gjitha detyrat e parashikuara nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" siç mund të ndryshojë kohë pas kohe.

**Neni 21**  
**Të ardhurat. Dividendi**

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas çmimeve dhe tarifave që i cakton vetë Shoqëria.

Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo ushtrimori, të deklaruar në pasyrat financiare të Shoqërisë, pas pagimit të tatimeve dhe detyrimeve të tjera të privilegjuara, mund t'i shpërndahen Ortakëve ose mund t'i shpërndahen ortakut të vetëm (në rast të shndërrimit me një ortak). Shpëndarja e fitimeve (dividendit) do të bëhet në raport me përqindjen e kuotës që Ortakët zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë.

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit finanziar të cilit i janë zbritur ose shtuar shumat respektive të humbjeve apo fitimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Humbjet e Shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo Ortak ose ortaku i vetëm (në rast të shndërrimit me një ortak), do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

**Neni 22**  
**Shkaqet e prishjes së Shoqërisë**

Shoqëria prishet :

- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarës në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit";
- me vendim të gjykatës.

**Neni 23**  
**Likuidimi**

Shoqëria do të hyjë në procesin e likuidimit nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të prishë Shoqërinë si dhe për çdo shkak tjetër të përcaktuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në mënyrë që të ndërmarrë procedurat e likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator ose një grup likuidatorësh. Nëse ky vendim nuk do të merret, atëherë çdo person i interesuar, brenda 30 ditëve pas prishjes, mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidator.

Në rastet kur Shoqëria prishet me vendim gjykate, likuidatori emërohet nga gjykata. Administratori njofton për rregjistrim në Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit, të dhënat e likuidatorit.

Detyra e likuidatorit është mbyllja e të gjithë veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributave të pashlyera, shitja e pasurive të Shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e preferimit në përputhje me Kodin Civil. Likuidatori do të raportojë mbi gjendjen e zërave të aktivit dhe të pasivit të Shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në fund të këtij proçesi, Asambleja e Përgjithshme shqyrton bilancin përfundimtar të përgatitur nga likuidatori dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

Në fund të procedurës së likuidimit dhe në rast se të gjithë kreditorët e Shoqërisë janë paguar dhe kështu Shoqëria i ka shlyer të gjithë detyrimet, kapitali i mbetur i kthehet Ortakëve ose ortakut të vetëm (në rast të shndërrimit me një ortak), kjo në përputhje me pjesët e zotëruara në kapitalin e Shoqërisë.

**Neni 24**  
**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin përgjatë veprimtarisë së Shoqërisë, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërtën, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë.

**Neni 25**  
**Ligji i Zbatueshëm**

Të gjitha çështjet që nuk trajtohen nga ky Statut në mënyrë të veçantë, apo nga Marrëveshja e Ortakëve, do të trajtohen dhe rregullohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 26**  
**Pavlefshmëria**

Në rast se ndonjë nga dispozitat e këtij Statuti do të jetë e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, atëherë dispozita në fjalë nuk do të konsiderohet juridikisht, ndërkohë që të gjitha dispozitat dhe nenet e tjerë të këtij Statuti do të mbeten në fuqi dhe të vlefshëm.

**Neni 27**  
**Dispozita Përfundimtare**

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë pasi është nënshkruar nga Ortakët.

Ky Statut hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën Shqipe, secila me të njëjtën vlerë juridike.

Ky Statut nënshkruhet sot në Tiranë, më datë 23.08.2023.

**ORTAKËT E SHOQËRISË  
"DV8" SH.P.K**

**Z. Albert LEKA**



**Z. Rezart Joanidhi**





## Kursi zyrtar

Periudha kohore	23.08.2023 - 23.08.2023
Monedha e zgjedhur	Euro (EUR)
Data	Lekë për njësi të monedhës së huaj
23.08.2023	107.63